

DITARI MUJOR

KORRIK 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

HAP SIPARIN “JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE 2025, EDICIONI II”, MINISTRJA PIRDENI: TRAJNIME NË AI PËR 600 PUNONJËS

Rikthehet “Java e Administratës Publike 2025 – Edicioni II”, organizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, me një seri aktivitesh shumëdimensionale dhe ndërvepruese për angazhim të hapur, reflektim dhe dialog vizionar duke nxitur mendim kritik në rrugëtimin e përbashkët drejt BE-së. JAP 2025, Edicioni II” u hap me forumin “Inteligjenca Artificiale dhe Transformimi Digjital i Shtetit”, organizuar nën kujdesin e MAPA, në bashkëpunim me AKSHI. Gjatë aktivitetit u prezantua marrëveshja e bashkëpunimit me Institutin Tony Blair për Ndryshim Global dhe organizatën Apolitical. Ky bashkëpunim synon trajnimin e mbi 600 punonjësve të administratës publike në përdorimin e Inteligjencës Artificiale, me fokus në aplikimin praktik të saj në shërbim të qytetarëve dhe rritjen e efikasitetit institucional. Nisma shënon një hap konkret drejt ndërtimit të kapaciteteve digjitale në administratë, duke u fokusuar në tematika të përshtatura me nevojat dhe sfidat e sektorit publik. Ministria Pirdeni tha se iniciativa të tilla sjellin përfitime sa më të prekshme në administratën publike.



“JAP 2025”, TË RINJTË DHE BIZNESI NË DIALOG GJITHËPËRFSHIRËS ME EKIPIN NEGOCIATOR, PIRDENI: PËRGATITJA ËSHTË URGJENCË!

Me energjinë e të rinjve dhe zërin e ekipit që negocion të ardhmen e Shqipërisë në BE, “JAP 2025” vijoi me eventin “Në Zemër të Integritit: Takim me Negociatorët”, me pjesëmarrjen e ministres Pirdeni, ministres Dhuka, Shefi i Seksionit Politik në Delegacionin e BE-së z. Andre Rizzo, ekipi negociatorë i Shqipërisë, etj. Forumi solli një bashkëbisedim të hapur, të gjallë dhe pa filtra mes studentëve, përfaqësuesve të biznesit dhe negociatorëve, duke nxitur reflektim dhe dialog rreth sfidave dhe mundësive që hap procesi i integritetit evropian, veçanërisht për brezin e ri, duke u përqëndruar në rëndësinë e zhvillimit të aftësive profesionale për të rinjtë si një element kyç në përgatitjen e tyre për tregun evropian të punës, mundësitë konkrete që sjell procesi i integritetit për gjeneratën e re në Shqipëri, si dhe rolin e dhomave të tregtisë dhe bashkëpunimit me sektorin privat në mbështetje të këtij transformimi. Ministria Pirdeni u shpreh se integriteti është një proces që kërkon bashkëpunim në të gjithë linjën, nga politikat, te arsimi, e deri te ekonomia, teksa shtoi se sot për të qenë pjese e tregut konkurrues evropian përgatitja e biznesit por edhe e të rinjve është urgjencë.



“JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE 2025” ÇELET EKSPOZITA “UDHËTIM I ADMINISTRATËS PUBLIKE NDËR VITE”

Në kuadër të “JAP 2025”, MAPA organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e partnerëve ndërkombëtarë, për të shkëmbyer ide dhe për të thelluar bashkëpunimin në kuadër të RAP. Më pas, të ftuarit patën mundësinë të vizitonin ekspozitën “Udhëtim i Administratës Publike Ndër Vite”, një përzgjedhje e pasur dokumentesh dhe fotografish arkivore që reflektojnë transformimin e administratës nga vitet e para të shtetformimit e deri më sot. Konceptuar si një retrospektivë edukative dhe dokumentare, ekspozita sjell për publikun një përzgjedhje të pasur dokumentesh zyrtare, fotografish arkivore dhe dëshmish historike, duke nxjerrë në pah rrugëtimin dhe transformimin e administratës publike në dekada. Ekspozita ishte homazh për të gjithë ata që me përkushtim i kanë shërbyer shtetit shqiptar ndër vite, si dhe një burim frymëzimi për brezat e rinj, që ndjekin karrierën në shërbimin publik.



“TI JE ASET”, VLERËSOHEN ME TROFE MË TË MIRËT E ADMINISTRATËS PUBLIKE

“JAP 2025” kulmoi me eventin “Ti je Aset”, i cili u rikthye për të dytin vit radhazi duke bërë bashkë punonjësit e administratës publike, Ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, drejtues të institucioneve dhe ekspertë. Eventu jo vetëm që vlerësoi punonjësit më të mirë të administratës publike, por shërbeu edhe si një platformë dialogu mes ekspertëve të fushës dhe vendimmarrësve, duke adresuar sfidat aktuale dhe nevojën e domosdoshme për reformimin e këtij sektorit. Në fokus të diskutimeve ishte nevoja për një administratë më të drejtë, më transparente, më motivuese dhe më të aftë për t’u përballur me sfidat e procesit të integritetit evropian. “Që vitin e kaluar kur e lançuam me shumë dedikim Javën e Administratës Publike, si çdo vend që e merr shumë seriozisht trajtimin e denjë të sektorit të vet publik, ishim plotësisht të vendosur që “Ti je Aset” do të kthehej në gurin e kurorës së kësaj jave. Puna e të gjithëve në përgjatë vitit ka si kryefjalë integritetin personal në punë dhe performancën e mirë që i bën nder misionit të të përbashkët. Përtej shembujve frymëzues që do të nderojmë sot, sistemi ka nevojë të reformohet në thelb: që të jetë më i drejtë, më transparent, më motivues dhe më i aftë për t’u përballur me sfidat e së ardhmes”, tha ministria Pirdeni.



EKIPET E MINISTRIVE MASIN “MUSKUJT” NË FUSHË, MAS FITON TROFEUN E VOLEJBOLLIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE 2025



Fryma e ekipit u rikthye në turneun e Volejbollit, organizuar në kuadër të “Javës së Administratës Publike, Edicioni II”. Me qëllim forcimin e frymës së bashkëpunimit dhe promovimin e një stili jetese të shëndetshëm, “Java e Administratës Publike Edicioni II”, duke vijuar traditën e një viti më parë organizoi Turneun e Volejbollit mes ministrive dhe Kryeministrit. Shpirti i garës doli në pah nga 11 ekipet e ministrive dhe Kryeministrit përgjatë një jave “të ethshme” të cilat u përballën me njëra-tjetrën. Në pallatin e sporteve “Asllan Rusi” në Tiranë, në praninë e ministres Pirdeni, u luajt ndeshja finale e Kampionatit të Volejbollit të Administratës Publike II, ku u përballën në një finale emocionuese MAS me Kryeministrinë. Ekipi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit u shpall fitues, duke treguar shpirt skuadre dhe energji pozitive në çdo set.

NJË DITË ME MAMIN DHE BABIN NË PUNË, ADMINISTRATA PUBLIKE HAP SËRISH DYERT PËR VOGËLUSHËT!

Administrata Publike mirëpriti fëmijët e punonjësve të saj në një ditë të mbushur me gjallëri entuziazëm dhe aktivitete argëtuese. Eventu i “Javës së Administratës Publike 2025, Edicioni II” kishte për qëllim të afronte botën e punës së prindërve me fëmijët e tyre për të kuptuar dhe prekur nga afër se çfarë bëjnë konkretisht në pesë ditët e javës. Edhe këtë vit, punonjësit e Administratës Publike iu bashkuan iniciativës, duke marrë fëmijët, mbështetjen në ambientin e punës, për t’i kultivuar njohjen me punën si dhe për të afruar edhe më tej kolegët dhe koleget me njëri-tjetrin. Dita e hapur për fëmijët përfshinte një sërë aktiviteteve edukative dhe argëtuese të organizuara posaçërisht për ta nëpër institucione dhe pritet të shndërrohet në vijim në një traditë të përvitshme në administratën publike, duke ofruar një mundësi të veçantë për të forcuar akoma më tej lidhjet midis familjes dhe punës.



“JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE 2025” MBYLL SIPARIN ME EVENTIN “PROKURIM QË FORCON BESIM: NGA NEVOJA NË CERTIFIKIM”



“Java e Administratës Publike 2025, Edicioni II” mbylli siparin me eventin “Prokurim që forcon besim: Nga nevoja në certifikim”. Eventu i organizuar në bashkëpunim me DAP, ASPA dhe Agjencinë e Prokurimit Publik bëri bashkë figura kyçe të administratës publike për të diskutuar mbi forcimin e integritetit në fushën e prokurimit publik dhe sfidat. Të pranishëm në panel ishin: Znj. Adea Pirdeni, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Z.Olton Muzaka, Drejtor i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Znj. Reida Kashta- Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik. Të tre drejtuesit ndanë vizionin dhe angazhimin e institucioneve që përfaqësojnë për ndërtimin e një administrate publike më transparente, më efikase dhe të orientuar drejt standardeve moderne të qeverisjes. Në vëmendje ishte rritja e integritetit dhe profesionalizmit në fushën e prokurimit publik, përmes procesit të trajnimit dhe testimit, që u finalizua me shpërndarjen e certifikatave për punonjësit e prokurimit publik.